



Përkrähje për Kosovën në Hörby "Shqiponja"

Statuti

§ 1. Qëllimi i veprimtarisë së shoqatës është:

1) Miqësia e përbashket ndërmjet kontakteve me Suedez, të tjerë si dhe shqiptarë në Hörby, me qëllimin që të mundsohet një integrim i ndërsjelltë në kulturë, aktivitete të ndryshme përparuese dhe tradita të grupeve të ndryshme etnike. Kjo të ndodhë përmes:

- Grupit vallëzues, valle popullore
- Gara sportive psh; futboll, pingpong, tenis, lojë me topa druri, shah, biljard etj.
- Grup për punë dore
- Bashkëpunim me shoqata tjera
- Teater dhe grup recitali
- Grupi të instrumentalistëve
- Të punohet për një integrim sa më të lehtë në shoqërinë suedeze si dhe të punohet për të drejtat e njeriut në vende ku ato nuk mbizotërojnë.
- Luftë kundër dukurive negative, si përdorimi i lëndëve narkotike, alkoolit, cigares etj.

2) Të ndihmohet popullit të Kosovës dhe të gjithë të tjerëve kudo që ka nevojë dhe në kemi mundësi. Kjo do të bëhet duke grumbulluar; ushqim, veshmbathje, pako higjienë-sanitare, teknikë, shtroj dhe mbuloj, barna, artikuj për ndihmë të parë, lodra, pajisje shkollore si (lapsa, fletore dhe të ngjajshme) dhe të mira materiale (para) si dhe duke organizuar kurse trajnuese të njohurisë, edukatës dhe prosperitetit.

3) Së bashku me organizata qeveritare dhe organizata jo qeveritare të zhvillojë njohuritë për demokraci, shoqëri dhe të ndihmonë njerëzve të sapodalur nga lufta.

§ 2. Organizimi

Shoqata përbëhet nga çdo anëtar që anëtarsohet, që janë të interesuar për aktivitete dhe që dëshirojnë të u ndihmojnë shqiptarëve të Kosovës dhe të gjithë atyre të tjerëve anëkund botës, të cilët kanë nevojë për ndihmë.

Për të qenë anëtar i shoqatës me të drejtë vote dhe vendim marrje si dhe për të zhvilluar aktivitete me të gjithë të tjerët duhet të paguhet anëtarësia e cila është për familje dhe qift në bashkëtesë me fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, shuma është 300kr/vit.

Kurse për individ apo person që kanë mbi **18 vjet 100 kr**, pamarr parasysh se ai apo ajo jeton në një bashkësi me dikënd tjetër apo me prinder. Nga momenti kur mbush 18 vjet është i obliguar të paguaj shumën prej 100kr. Vetëm nëse i mbush në mes të vitit atëherë i

lejohej te jet në bashk-pages me prinderit apo grupin qe ka qenë deri në vitin paraprak. Kuvendi vjetor i shoqatës është instanca më e lartë. Kryesia udhëheq punën ndermjet kuvendeve vjetore.

§ 3. Kuvendi Vjetor

- a) Kuvendi vjetor mbahet çdo vit, me se largu në fund të muajit shkurt.
- b) Ftesat për kuvend vjetor dergohen 14 ditë para mbajtjes së kuvendit vjetor.
- c) Propozimet duhet të vin në kryesi një javë para kuvendit vjetorë.
- d) Çdo anëtar, mbi moshën 18-vjeçare, që ka paguar anëtarisin ka të drejtë votë.
- e) Paragrafi për kuvendin vjetor:
 1. Takimi hapet
 2. Pyetja se a është shpall kuvend në mënyrë të drejtë
 3. Zgjedhja e kryesis së punës
 - A) Kryetari
 - B) Sekretari - Proçes mbajtës
 - D) Dy verifikues të proçes verbalit të kuvendit.
 - 4) Raporti vjetor mbi punën një-vjeçare.
 - 5) Raporti i revizionimit
 - 6) Pyetja nëse kryesia lirohet nga përgjegjësia
 - 7) Propozimet shqyrtohen
 - 8) Vendimi për pagesën vjetore të anëtarësis
 - 9) Zgjedhja e kryesisë se re të shoqatës
 - A) Kryetar për 1 vit
 - B) Sekretar për 2 vite
 - C) Arkatar për 2 vite
 - D) Disa anëtar të kryesis (simbas nevojës caktohet numri i anëtarvë) për 2 vite (nëse anëtari i ri ka vitin e parë mund te zgjidhet për vetem një vit)
 - E) 2 Zëvendës për 1 ose 2 vite
 - F) 1 ose më shumë revizor (kontrollues) dhe një zëvendes për 1 vit.
 - G) Komisioni përgatitor i zgjedhjeve përfshin zgjedhjet e përbashkëta dhe 2 anëtar.
 - H) Revizorët dhe komisioni zgjedhor nuk jan pjesë e kryesis.
 - I) Kryesia ka të drejtë për vendimmarrje nese se paku 3 persona jan të pranishem.
 - 10) Pyetje të ndryshme shqyrtohen
 - 11) Mbledhja përfundon.

§ 4. Kuvend i jashtëzakonshëm

Kryesia ka të drejtë të thërret takim të jashtëzakonshëm nëse parasheh nevojë. Takim i jashtëzakonshëm mund të thirret poashtu nëse 51 % e anëtarëve mbi 18 vjet deshirojn. Në rast të mbledhjes së jashtëzakonshme mund te trajtohen vetem pyetjen te cilat figurojn në thirrje. Thirrja për mbledhje të jashtëzakonshme duhet t'ju dergohet anëtarëve 7 ditë para mbledhjes.

§ 5. Takimi i jashtëzakonshëm me anëtar

Kryesia mund të thërret për mbledhje të jashtëzakonshme me anëtarët e vet nëse ka për tu marr ndonje vendim i veçant. Njëkohësisht mund të therrasin edhe anëtarët për mbledhje të jashtëzakonshme, mbi 50 % të anëtarëve, me 51 % të nënskrimeve të anëtarëve.

§ 6. Kryesia

Shoqata udhëhiqet nga një kryesi, e cila përbëhet nga 5 anëtar të kryesis apo me shumë. Kryesia zgjidhet nga kuvendi vjetor, ku kryetari, sekretari dhe arkatari zgjidhen të veçant (veç e veç). Postet tjera mund ti ndaj kryesia vetë.

§ 7. Veprimtaria, viti fiskal dhe revizionimi

Veprimtaria dhe viti fiskal (kontabilist) është nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Kontabiliteti (librat e arkës) bashkë me protokol lihet të revizoret me se voni 45 ditë para kuvendit vjetor.

§ 8. Pyetja e statutit dhe shuarja e veprimtaris

Nese statuti kërkohët të ndrrohet, duhët të behet përmes vendimit nga dy mbledhje të anëtarëve, ashtu që njera të jetë kuvendi vjetor. Shoqata mund të shuhet nese 51% të anëtarve mbi 18 vjeç dëshirojn , duhet me qenë me se paku 2/3 e anëtarëve mbi 18 vjeç. Mjetet eventuale i jipen organizatës humanitare Nëna Terezë në Kosovë. Anëtarët që nuk e paguajn anëtarsin ose i thejnë rregullat e statutit dhe rrëgulloret tjera mund të përjashtohen menjëherë.